

URDHËR
Nr. 183, datë 30.12.2025

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR PROMOVIMIN E
EKSPORTEVE DHE NDËRKOMBËTARIZIMIN E NDËRMARRJEVE,
PËRFSHIRË LEHTËSIMIN E EKSPORTEVE DHE TREGTISË PËRMES
KORRIDOREVE TË GJELBRA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 24, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, në zbatim të vendimit nr. 621, datë 10.10.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit të politikës ‘Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027’”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”, si dhe të masës 1.1.6 “Promovimi i eksportit dhe ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve, duke përfshirë lehtësimin e eksporteve dhe tregtisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Veprimit për Promovimin e Eksporteve dhe Ndërkombëtarizimin e Ndërmarrjeve, përfshirë lehtësimin e eksporteve dhe tregtisë përmes Korridoreve të Gjellbra, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri, i cili është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, sipas fushës së përgjegjësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT
Delina Ibrahimaj

Dokument politikash "axhenda kombëtare e reformave 2024-2027" në kuadër të instrumentit të bashkimit evropian "faciliteti për reforma dhe rritje për ballkanin perëndimor"

Nisma Intra-CEFTA e Komunitetit të Transportit–CEFTA për “Korridoret e Gjellbra”, e mbështetur nga Komisioni Europian, u krijua në fillim të pandemisë COVID-19. Arritja e saj kryesore ka qenë ruajtja e flukseve të tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor. Korridoret e gjellbra ekzistuese kanë sjellë përfitime të konsiderueshme ekonomike, duke u dëshmuar thelbësore në lehtësimin e eksporteve brenda CEFTA-s/Ballkanit Perëndimor; duke kursyer pothuajse 20 vjet kohë pritjeje të akumuluar, ato kanë siguruar vijimësinë e funksionimit të zinxhirëve të furnizimit, kanë rritur tregtinë dhe kanë përmirësuar tërheqjen e rajonit për investitorët.

Duke u mbështetur në suksesin e saj në Ballkanin Perëndimor, nisma për Korridore të Gjellbra që lidhin BE-në me Ballkanin Perëndimor është shfaqur si prioritet strategjik. Kjo nismë, e ndërmarrë bashkërisht nga Sekretariatet e Komunitetit të Transportit dhe të CEFTA-s, me mbështetjen e Komisionit Europian, u përcaktua si prioritet në Samitin BE–Ballkani Perëndimor në Sofje në vitin 2020 dhe u rikonfirmua në samitet pasuese.

Për të siguruar një mjedis të përshtatshëm për rritjen e eksporteve, lehtësimi i tregtisë dhe transportit me shtetet anëtare të BE-së, si dhe me vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, duhet të trajtohet. Në këtë drejtim, synimi është që lehtësimi i tregtisë dhe transportit të sigurohet edhe përmes përvojës së “Korridoreve të Gjellbra”, të cilat u krijuan me shpërthimin e COVID-19 për të parandaluar mungesat e mallrave thelbësore dhe pajisjeve mjekësore. Nisja e kësaj nisme është provuar si një nga shembujt më të suksesshëm të bashkëpunimit rajonal, duke arritur të ruajë flukset tregtare, jo vetëm për përfitime ekonomike, por edhe për një luftë efektive kundër pandemisë.

BE-ja është partneri kryesor tregtar i Ballkanit Perëndimor/CEFTA-s, me një peshë pothuajse 70% në tregtinë e përgjithshme, ndërsa të gjitha ekonomitë janë në marrëdhënie kontraktuale me BE-në dhe synojnë të bëhen përfundimisht anëtare të saj. Plani i Veprimit për Krijimin e Tregut të Përbashkët Rajonal (AP CRM) shihet si një gur themeli drejt integritetit më të ngushtë me BE-në. Forcimi i marrëdhënieve ndërmjet administratave doganore mund të jetë hapi i parë në këtë drejtim për të paktën dy arsye. Së pari, ekziston nevoja për të përshpejtuar lëvizjen e mallrave nga Ballkani Perëndimor drejt BE-së.

Për më tepër, shërbimet e BE-së kanë qenë thellësisht të përfshira në operacionalizimin e AP CRM, duke vendosur kështu kontekstin për një përmirësim gradual dhe të qëndrueshëm të bashkëpunimit. Lehtësimi i transportit dhe tregtisë është thelbësor për lëvizje të përshpejtuar të mallrave dhe duhet të mundësojë rritje të tregtisë, duke siguruar ekuilibrin ndërmjet liberalizimit dhe thjeshtimit të nevojshëm nga njëra anë, dhe sigurisë e mbrojtjes

nga ana tjetër. Bashkëpunimi i përmirësuar ndërmjet të gjitha agjencive të përfshira në procesin e zhdoganimit do të mbështesë ndjeshëm rritjen ekonomike duke:

- përmirësuar mjedisin e biznesit
- shkurtuar kohët e pritjes
- ulur kostot e tregtisë
- rritur transparencën
- përmirësuar bazën për menaxhimin e risqeve
- siguruar sigurinë dhe mbrojtjen e zinxhirëve të vlerës.

Megjithatë, nevojitet shumë më tepër progres në këtë drejtim dhe, për këtë arsye, synimi është miratimi i një programi për lehtësimin e tregtisë dhe transportit, i cili përfshin si komponent Korridoret e Gjelbra, me masat përkatëse “soft” dhe “hard”, veprimet dhe ndërhyrjet e kostuara për zbatim, siç parashikohet në Udhëzuesin ETC.

Ky dokument politikash paraqet një paketë të koordinuar për zbatimin e plotë të Korridoreve të Gjelbra përgjatë korridoreve prioritare tregtare të Shqipërisë dhe pikave të kalimit kufitar (BCP). Ai përcakton masat ligjore, procedurale, operacionale dhe digjitale të nevojshme për të reduktuar kohën, koston dhe variacionin për flukset tregtare në përputhje, duke ruajtur njëkohësisht kontrollet me interes publik si SPS, siguria dhe mbrojtja.

Objektivat kryesore të këtij plani përfshijnë:

- Zgjerimin dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe procedurave të Korridoreve të Gjelbra në korridoret/BCP-të prioritare.
- Rritjen e parashikueshmërisë duke mundësuar që eksportuesit të përmbushin dritaret e dorëzimit.
- Përmirësimin e efikasitetit të transportit në nyjet kryesore përmes procedurave paraprake
- Zbatimin e praktikave në lidhje me Operatoret Ekonomik të Autorizuar

Aktivitetet do të financohen përmes një kombinimi të alokimeve nga buxheti i shtetit, asistencës IPA, instrumenteve të kredisë dhe donatorëve dypalësh si Banka Botërore. Afatet e aktiviteteve të përfshira në projektin TTFP2.0 mund të ndryshojnë në varësi të maturimit të projektit në NSPP.

Ky plan veprimi operacionalizon drejtpërdrejt Planin e Rritjes – Aktiviteti 1.1.6 “Promovimi i eksporteve dhe ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve, përfshirë lehtësimin e eksporteve dhe tregtisë, si dhe mbështetjen e zinxhirit të vlerës për industri të përzgjedhura me potencial rritjeje”. Duke bashkuar Korridoret e Gjelbra me menaxhimin e riskut të përputhshëm me BE-në, zgjerimin e AEO dhe digjitalizimin e Dritares së Vetme, politika e kthen objektivin e Planit të Rritjes në përmirësime të matshme të performancës kufitare,

besueshmëri më të mirë logjistike dhe gatishmëri më të lartë për eksport për firmat shqiptare, veçanërisht NVM-të.

Titulli i reformës	Mbështetje financiare nga BE (EUR)	Kushtet e pagesës	Burimi i verifikimit	
1.1.6 Promovimi i eksporteve dhe ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve, përfshirë lehtësimin e eksporteve dhe tregtisë, dhe mbështetjen e zinxhirit të vlerës për industri të përzgjedhura me potencial rritjeje.	3,008,437	Përparim i vazhdueshëm në zbatimin e nismave të Korridoreve të Gjelbra për lehtësimin e tregtisë, përmes miratimit të një programi për lehtësimin e tregtisë dhe transportit.	Dokumenti i programit të masave (përfshirë masat për zbatimin e Korridoreve të Gjelbra	

**PLANI I VEPRIMIT PËR PROMOVIMIN E EKSPORTEVE DHE NDËRKOMBËTARIZIMIN E NDËRMARRJEVE,
PËRFSHIRË LEHTËSIMIN E EKSPORTEVE DHE TREGTISË PËRMES KORRIDOREVE TË GJELBRA**

Veprimet	Afati	Institucionet	Mbështetja financiare	Produkti/Rezultati
Rezultati 1: Përmirësimi i infrastrukturës në BCP/CCP me Palët e CEFTA dhe Shtetet Anëtare të BE-se				
Kakavijë–Ktismata Kapshticë–Krystalopigi Qafë Thanë–Kjafsan Bllatë–Blato Hani Hotit - Bozaj				
BCP/CCP Shqipëri – Maqedonia e Veriut				
1. Përfundimi i fazës së parë të projektit të rindërtimit të BCP Qafë Thanë/Kjafasan financiar përmes TTFP1 (Banka Botërore)	Dhjetor 2026			
2. Investime në Pikën e Kalimit Kufitar Bllatë–Blato		Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	Projekti i Bankës Botërore TTFP2.0	Shtimit të një korsie eksporti dhe zgjerimi i korsisë së importit Zhvendosja e peshores Zgjerimi i hapësirës së parkimit Nevoja të vogla për pajisje

2.1 Diskutimi dhe nënshkrimi i një protokolli zbatimi për Pikën e Kalimit Kufitar Bllatë–Blato	2029	Drejtorja e Përgjithshme e Doganave Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	N/A	
BCP/CCP Shqipëri – Mali i Zi				
1. Pika e Kalimit Kufitar Hani i Hotit 1.1 Propozim për instalimin e urës së peshimit: Një urë peshimi mbi tokë me monitorim dhe kontroll të largët të trafikut 1.2 Zëvendësimi i sallës ekzistuese të inspektimit me një strukturë të re që përmban një portal skanimi "drive-through".		Drejtorja e Përgjithshme e Doganave	Projekti i Bankës Botërore TTFP2.0	Zgjatja e orarit të funksionimit duke përdorur një terminal doganor të dedikuar 1 km larg Axhushime rrugore Përmirësimi i efikasitetit të peshimit të kamionëve Instalimi i skanerit
BCP Shqipëri – Greqi				
Zbatimi i MoU dypalësh Shqipëri–Greqi për të përshpejtuar Korridoret e	Në vijim	Drejtorja e Përgjithshme e Doganave	N/A	Faza 1: Shkëmbimi i të dhënave për mallrat nëpërmjet transportit rrugor dhe për kamionët e bosh që nisen nga

Gjelbra dhe për të thjeshtuar flukset ndërkufitare.				territori i Republikës së Shqipërisë. Faza 2: Nënshkrimi i një memorandumi mbështetës për shkëmbimin e të dhënave të mallrave nëpërmjet transportit rrugor për kamionët e bosh nga territori i Republikës së Greqisë, nëse faza e parë do të rezultojë e suksesshme. Stafi doganor i trainar nga projekti SEED.
Shkëmbimi i të dhënave para-mbërritjes (pre-arrival data) dhe të dhënat në dalje				Zbatimi i Protokollit për shkëmbimin e të dhënave
Përgatitja e projektit për përmirësim fizike dhe modernizim të pajisjeve, sipas ficherit për BCP Kakavijë/Ktismata	Dhjetor 2026	Drejtorja e Përgjithshme e Doganave Autoriteti Kombëtar i Ushqimit Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Projekti i Bankës Botërore TTFP2.0	Investime në infrastrukturë, shtim korsie eksporti Modernizimi dhe përmirësim i faciliteteve të vjetruara / rreshta shtesë për kamionë / sinjalistikë trafiku / peshore Integrimin e

				zyrave të përkohshme të sigurisë ushqimore. ▪ Masa shtesë për PKK-në e Kakavijës: Iniciativa BE-Ballkani Perëndimor "Korsi të Gjellbra" sugjeron instalimin e sistemeve ANPR, inspektime me qen nubatës dhe krijimin e korsive të dedikuara për kamionë, me integrimin e sistemeve të të dhënave të policisë doganore dhe kufitare si një qëllim afatgjatë.
Përgatitja e projektit për përmirësime fizike dhe modernizim të pajisjeve për BCP Kapshticë/Krystalopigi	Dhjetor 2026	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Autoriteti Kombëtar i Ushqimit Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Projekti i Bankës Botërore TTFP2.0	Modifikime të korsive, shtim të korsive të eksportit zgjerim të parkimit Modernizimi dhe përmirësim i faciliteteve të vjetruara
Rezultati 2: Orari i punës harmonizohet ndërmjet autoriteteve doganore në BCP				

Harmonizimi i orarit të punës në Kakavijë–Ktismata për inspektimin ushqimor, veterinar dhe fitosanitar (nga 08:00–22:00 në 07:00–22:00)	Mars 2026	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Autoriteti Kombëtar i Ushqimit Policia e Shtetit	N/A	
Harmonizimi i orarit të punës në Kapshticë–Krystalopigi për inspektimin ushqimor, veterinar dhe fitosanitar (nga 08:00–22:00 në 06:00–22:00)	Mars 2026	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Autoriteti Kombëtar i Ushqimit Policia e Shtetit	N/A	
Harmonizimi i orarit të punës në Kapshticë–Krystalopigi për inspektimin ushqimor, veterinar dhe fitosanitar (nga 08:00–22:00 në 06:00–22:00)	Mars 2026	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Autoriteti Kombëtar i Ushqimit Policia e Shtetit	N/A	
Rezultati 3: Programet AEO zbatohen plotësisht dhe janë operacionale				
1. Zbatimi i programeve ekzistuese AEO	Në vijim	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	N/A	Përdorim më i mirë i programeve ekzistuese të njohjes së ndërsjellë AEO, duke

				rezultuar në rritje të përfitimeve praktike për operatorin AEO
2. Zhvillimi i programeve të njohjes së ndërsjellë AEO me Palët e tjera të CEFTA-s, duke filluar me Malin e Zi.	2027	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	N/A	Lehtësim i forcuar rajonal i tregtisë përmes njohjes së ndërsjellë të statusit AEO ndërmjet Palëve të CEFTA-s, duke filluar me Malin e Zi, duke çuar në uljen e dublimeve të kontrolleve dhe zhdoganim më të shpejtë për operatorët në përputhje, në përputhje me procesin e anëtarësimit në BE të Shqipërisë dhe Malit të Zi.
3. Zgjerimi i programeve të njohjes së ndërsjellë me shtetet fqinje anëtare të BE-së, Greqinë dhe Italinë	2027	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	N/A	Eksplorimi i zgjerimit të njohjes së ndërsjellë ndërmjet programit AEO të BE-së dhe programit AEO të Shqipërisë, me synim shtrirjen e përfitimeve të njohjes së ndërsjellë në të gjitha Shtetet Anëtare pjesëmarrëse të BE-së dhe operatorët ekonomikë të besuar.
4. Mbështetje për bizneset në marrjen e statusit AEO	Në vijim			Rritja e numrit të operatorëve ekonomikë në përputhje që marrin statusin AEO duke ofruar informacion të targetuar

				dhe mbështetje këshillimore për bizneset që përgatisin aplikimet AEO, me 20% çdo vit. Organizimi i fushatave të dedikuara për të publikuar përfitimet e statusit AEO dhe rastet më të mira në këtë drejtim.
5. Rritja e gatishmërisë së doganave për autorizim AEO duke hartuar Procedurat Standarde të Operimit (SOP)	Qershor 2026	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	N/A	Ky SOP përcakton procedurat standarde për punonjësit doganorë në kufi kur një operator AEO përpunohet në pikën e kalimit kufitar.
Rezultati 4: Strategjia e Menaxhimit të Riskut Doganor të CEFTA-s zbatohet, duke siguruar kontrolle të harmonizuara dhe të bazuara në risk në të gjitha Palët e CEFTA-s				
1. Rishikim i rregullt i listës së përbashkët të mallrave të prishshme në Korridorin e Gjellbër për të përfshirë fruta dhe perime të freskëta	2027	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	N/A	Listë e përditësuar e përbashkët e mallrave të prishshme në Korridorin e Gjellbër, duke përfshirë kategori të dakorduara të frutave dhe perimeve të freskëta bazuar në vlerësim të përbashkët risku dhe nevoja tregtare.
2. Vendosija e kontrolleve të vazhdueshme, të koordinuara në BCP/CCP	2027	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	N/A	Niveli CEFTA

		Autoriteti Kombëtar i Ushqimit		
		Policia e Shtetit		
Ndryshimi i kuadrit ligjor ekzistues për Sigurinë Ushqimore për të futur kontrollet e produkteve bujqësore bazuar në vlerësimin e riskut	2027	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	N/A	Ndryshimi i ligjit “Për Ushqimin”, ligjit “Për mbrojtjen e bimëve” dhe Ligjit “Për prodhimin biologjik”.
Forcimi i kapaciteteve të AKU-së për të zhvilluar profile risku në përputhje me analizën e riskut doganor	2026	AKU Drejtorja e Përgjithshme e Doganave	Buxheti i shtetit Projekte dypalëshe	AKU të krijojë dhe të përdorë profile risku të harmonizuara me analizën e riskut doganor, të mbështetura nga staf i trajnuar dhe procedura të dakorduara për kontrolle të përbashkëta të bazuara në risk.
Rezultati 5: Zbatim efektiv i SEED+ për lehtësimin e mëtejshëm të informacionit para mbërritjes				
Mirëmbajtja e SEED+ si mekanizëm monitorimi për të ofruar të dhëna në kohë reale në BCP	2027	Drejtorja e Përgjithshme e Doganave Autoriteti Kombëtar i Ushqimit Policia e Shtetit	Sekretariati i CEFTA-s	SEED+ përdoret si mekanizëm monitorimi në kohë reale, duke ofruar të dhëna të përditësuara për lëvizjet e mallrave, kontrollet dhe flukset e trafikut në BCP.
Përdorimi i platformës Galileo / ose të ngjashme për	2026	Drejtorja e Përgjithshme e Doganave		xx

të matur kohën totale të pritjes				
Nënshkrimi i MoU-ve me vendet kufitare për shkëmbimin e informacionit doganor para mbërritjes	2026	Drejtorja e Përgjithshme e Doganave Autoriteti Kombëtar i Ushqimit Policia e Shtetit		
Zbatimi i projektit WB TTFP II	2030			
Rezultati 6: Bashkëpunimi ndërmjet agjencive në BCP përmirësohet				
Aderimi në Konventën e Tranzitit të Përbashkët	2027	Drejtorja e Përgjithshme e Doganave		
Zbatim i vazhdueshëm i proceseve dhe procedurave në kuadër të Menaxhimit të Integruar të Kufirit (IBM)		Drejtorja e Përgjithshme e Doganave Policia e Shtetit Autoriteti Kombëtar i Ushqimit		
Vendosja e treguesve kyç të performancës (KPI) për kontrollin e mallrave në BCP/CCP.	Qershor 2026	Drejtorja e Përgjithshme e Doganave Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	N/A	Monitorim dhe vlerësim i përmirësuar i kontrolleve në BCP/CCP, duke çuar në kontrolle më efektive, të

				bazuara në risk dhe më të qëndrueshme të mallrave.
Forcimi i bashkëpunimit dhe partneritetit me Shokatën Rajonale AEO	Në vijim	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	N/A	Koordinim dhe shkëmbim informacioni i përmirësuar ndërmjet doganave dhe Shokatës Rajonale AEO, duke çuar në zbatim më efikas të lehtësimeve AEO. Dialog dhe bashkëpunim i përmirësuar përmes eventeve të rregullta të përbashkëta (tryeza të rrumbullakëta dhe punëtori).
Ngritja e kapaciteteve për autoritetet doganore në përmirësimin e shërbimeve doganore	Në vijim	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	Projekt dypalësh Sekretariati i CEFTA-s Komuniteti i Transportit Banka Botërore	
Krijimi i një sistemi të përshtatshëm menaxhimi të korsive në BCP/CCP të përzgjedhura, me pajisje dhe infrastrukturë mbështetëse që lejon ndarjen e makinave, autobusëve dhe kamionëve dhe menaxhimin e fluksit të		Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Autoriteti Kombëtar i Ushqimit Policia e Shtetit		
trafikut gjatë periudhave me ngarkesë të lartë.				